emc studio
Enviromental Managaments Consultans ltd

Rr. "Kavajes", Pallati "BAJA-BAD", Kati 11, Ap. 48, Tiranë (Shqipëri) Cel: +355692076779;
web: www.emcstudio.al

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN:

"SHFRYTEZIM ME KARRIERE E GURIT GELQEROR (SHTESA)"

Vendodhja :Zona Minerare Nr 56/6, Objekti Gjergjove, Fshati Gjergjove, Njesia Administrative Potom, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

Kërkues: Subjekti: "GENER 2" Sh.p.k

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu

emc studio
Environmental Management Consultants ltd

Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Pasqyra e lëndës

1. HYRJE 3

2. QËLLIMI I HARTIMIT TË RAPORTIT TE VNM-se DHE LEGJISLACIONI I KONSULTUAR 4

2.1. Qëllimi i projektit 4

2.2. Qëllimi i hartimit të raportit VNM 4

2.3. Legjislacioni i konsultuar për realizimin e VNM 5

2.4. Metodika e zbatuar 5

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK 6

3.1. Vendodhja e objektit 6

3.2. Elementet e marre ne konsiderate per menyren e shfrytezimit te objektit 7

3.3. Kapaciteti prodhues 7

3.4. Grafiku i zbulimit dhe prodhimit 8

3.5. Variantet e hapjes se vendburimit 8

3.6. Sistemi i shhytezimit te treguesve tekniko-ekonomik te tyre. 9

3.7. Radha dhe drejtimi i shfrytezimit 9

3.8. Menyrat e rrezimit ne karriere e gurit gelgeror 0

3.9. Infrastruktura e nevojshme 0

3.10. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre 0

3.11. Te dhena per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit. 0

4. VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT 1

4.1 Të dhëna per zonen e zhvillimit te aktivitetit 1

4.2 Të dhëna per Bashkine Skrapar 1

4.3 Gjeologjia 3

4.4 Gjeografia e zones minerare 5

4.5 Klima 5

4.6 Hidrologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit 5

4.7 Biodiversiteti 6

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT 7

5.1 Ndikimi ne Toke 7

5.2 Ndikimi ne uje 7

5.3 Ndikime ne ajer 7

5.4 Ndikime ne Biodiversitet 8

1. HYRJE

Ekonomia shqiptare është duke u zhvilluar me ritme te shpejta ne drejtim te integrimit te saj rajonal, Evropian dhe botëror. Vendi ynë aktualisht është duke u përballur me sfidat e integrimit ne Bashkimin Evropian, gjë e cila përfshin angazhimin për ndërtimin e kapaciteteve te reja ekonomike, përshtatjen e teknologjive, si dhe integrimin e ekonomisë shqiptare ne hartën e tregjeve rajonale dhe ndërkombëtare. Ky përbën një proces kryesor për te garantuar koherencën dhe vazhdimësinë e strategjive, te reformave, si dhe te prioriteteve te ekonomisë shqiptare, te cilat janë te nevojshme ne kushtet e një ekonomie te tregut te lire. Arritja e këtyre objektivave parësore do te behet e mundur nëpërmjet politikave efektive, konsolidimit dhe zhvillimit te sektorëve kryesore te ekonomisë kombëtare, konsolidimit te institucioneve dhe hartimit e implementimit te projekteve, te cilët realisht do ta integrojnë ekonominë Shqiptare, duke u bazuar ne drejtimet kryesore te "Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim", si dhe ne strategjitë sektoriale dhe rajonale. Përpjekjet konstante për harmonizimin e politikave te rritjes ekonomike me kërkesat e standardeve mjedisore, përbejnë gjithashtu një drejtim tjetër themelor te programeve te Qeverise për një zhvillim te qëndrueshëm te vendit.

Eksperienca e vendeve të zhvilluara ka treguar se, për të pasur një zhvillim normal të sektorit industrial duhet të vendoset një balancë e drejtë ndërmjet politikave qeverisëse dhe mekanizmave të tregut, si dhe menaxhimit të energjisë.

Ky aktivitet ka si synim shfrytezimin per siperfaqen shtese, me karriere te gurit gelqeror, me vendodhje ne objektin Gjergjove, zona minerare nr 56/6, Skrapar, Qarku Berat.
Shfrytezimi i karrieres do sherbeje per perftimin e materialeve inerte te nevojshme per ndertimin e rrugeve dhe urave ne sherbim te projektit te gazsjellesit TAP.

Kompania ka te qarte rrugen dhe hapat per ta realizuar kete projekt ne variantin e tij me optimal.

Nepermjet ketij raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis do te jepet nje informacion i permbledhur i projektit te shfrytezimit, informacion mbi zonen dhe popullsine e saj, punimet qe do te kryhen, ndikimet ne mjedis nga zbatimi i projektit, masat qe duhet te merren per minimizimin e ketyre ndikimeve, si dhe impaktin ekonomiko-social.

2. QËLLIMI I HARTIMIT TË RAPORTIT TE VNM-se DHE LEGJISLACIONI I KONSULTUAR

2.1. Qëllimi i projektit

Qellimi i projektit eshte shfrytezimi me karriere i gurit gelqeror, me vendodhje ne objektin Gjergjove, zona minerare nr 56/6 me siperfaqe 0.129 km^2, Skrapar, Qarku Berat.

Shfrytezimi i karrieres do sherbeje per perftimin e materialeve inerte te nevojshme per ndertimin e rrugeve dhe urave ne sherbim te projektit te gazsjellesit TAP.

2.2. Qëllimi i hartimit të raportit VNM

Projekti i hartuar ka per qellim shqyrtimin e mundesive te shfrytezimit te karrieres se gurit gelqeror qe ndodhet ne krahe te djathte te rruges Potom, ne territorin e rrethit Skrapar, Qarku Berat.. Zona e projektit per siperfaqen shtese zë një sipërfaqe totale prej 0.129 km^2.

Synimi kryesor i përgatitjes së raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikohen ndikimet e mundshme negative të zbatimit të projektit në vlerat natyrore të zonës ku do të zbatohet si dhe vlerësimi i performancës mjedisore të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të zbatimit të tij.

Ky vlerësim arrihet përmes:

- Evidentimit të pikëprerjeve dhe bashkërendimit të projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- Identifikimit të statusit mbrojtës të zonave ku do të zhvillohet projekti;
- Përshkrimit të vlerave natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit;
- Identifikimit të ndikimeve të mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i VNM përmbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

2.3. Legjislacioni i konsultuar për realizimin e VNM

Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligj nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
- Ligj nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve";
- Ligj nr.8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja";
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis";
- Ligj nr. 9587 datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit";
- Ligj nr. 8906 datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura";
- VKM nr.13 datë 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis";
- VKM nr. 247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

2.4. Metodika e zbatuar

Për të hartuar pjesën përshkrimore të raportit, vlerësimin e ndikimeve dhe planin e menaxhimit u përdorën dhe analizuan të dhënat e përftuara nga vrojtimet në terren si dhe burime sekondare informacioni. Matjet në terren përfshijnë: matjen e nivelit egzistues të zhurmës; vlerësimin e cilësisë së ujërave në zonë; vlerësimin e mbulesës bimore në zonën e projektit si dhe vrojtime për cilësinë e habitatit dhe prezencën e specieve faunistike. Gjatë vrojtimit u vlerësuan edhe ndikimet egzistuese në zonën e projektit.

Përshkrimi i projektit është bazuar në projektin tekniko - minerar dhe në të dhënat e studimeve përkatëse në lidhje me hidrologjinë, topografinë dhe gjeologjinë inxhinierike të terrenit në të cilin propozohet të zhvillohet aktiviteti.

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK

3.1. Vendodhja e objektit

Vendburimi i Gurit Gelqeror ndodhet ne territorin e Fshatit Gjergjove, te rrethit te Skraparit, ne veriperendim te fshatit Gjergjove ne nje distance rreth 0.5 Km large ne vije ajrore. Zona e projektit zë një sipërfaqe totale prej 0.129 k m^2.

Koordinata ne sistemin Gaus Kruger

Nr. pikës	Koordinatat Y	X
1	44 43 974	44 82 682
2	44 44 299	44 83 101
3	44 44 570	44 82 876
4	44 44 593	44 82 914
5	44 44 318	44 82 142
6	44 44 745	44 82 984
7	44 44 870	44 82 757
	Sipërfaqja	***0.129 km²***

Harte Topografike e zones ne vleresim



Nga pikpamja gjeografike objekti yne ndodhet ne rrethin e Skraparit, ben pjese ne Shqiperine jugore, ne pjesen very-lindore te krahines malore jugore. Relievi eshte malor kodrinor me lartesi mesatare 788 m. Pika me e larte e zones eshte maja e Ostravices 2383 m. Lumenjt kryesore jane lumi Tomorrices dhe Osumit. Zonat me te ngritura malore jane Tomorrica, Kulmaku dhe zona e Potomit. Objekti ndodhet ne lindje te rrethit te Skraparit ne territorin e Njesise Administrative Potom Fshati Gjergjove. Lartesia maksimale e objektit eshte 1151 m nga niveli I detit.

3.2. Elementet e marre ne konsiderate per menyren e shfrytezimit te objektit

Topografia e zones se projektuar, sasia e rezervave te shfrytezueshme te gurit gelqeror, karakteristikat gjeomekanike te shkembinjve, koeficenti i zbulimit.

Shfrytezimi me karriere i gurit gelqerore favorizohet nga faktoret:

Renia e formacioneve , qe ndertojne pakon produktive ne drejtim te tille qe lejojne zhvillimin normal te shkallleve dhe elementeve te tyre pa sjelle kushtezime teknike.

Elementet e shtruarjes se formacioneve te gurit gelqeror dhe karakteristikat gjeomekanike te tyre favorizojne kendet deri ne 75 ° te skarpatave dhe nuk sjelin asnje rrezik rreshkitje.

Nga hidrografia e zones nuk pritet te krijohet problem gjate shfrytezimit te vendburimit, mbasi siperfaqja eshte plotesisht e drenuar dhe nuk ka problem ujrash dhe burimesh te pranishme ne te.

3.3. Kapaciteti prodhues

Prodhimi i gurit gelqeror me karriere ne zonen e projektuar do te ket destinacion perdorimin ne infrastrukturen rrugore te aksesit te TAP dhe lende te pare per prodhim inertesh.

Per kete arsye, ne varesi te kerkesave per perdorim vetiak, subjekti parashikon nje prodhim vjetor rreth 100 000 m^3/vit.

3.4. Grafiku i zbulimit dhe prodhimit

Grafiku i prodhimit te ndare nder vite ne shkallet e karrieres

Nr.	Emertimi i shkaleve	Rezervat e shfrytezueshme te Gurit gelqeror m3	Vti Ire	Vti II^{te}	Vti III^{te}	Vti IV^{te}	Vti Vte
1	1140-1150	24 003	24 003				
2	1130-1140	60681	60681				
3	1120-1130	116144	15 316	100000	828		
4	1110-1120	171384			99172	72212	
5	1100-1110	226060				27788	100000
	Shuma	598 272	100000	100000	100000	100000	100000

3.5. Variantet e hapjes se vendburimit

Vendburimi eshte hapur nga rruga ekzistuese qe pershkon vendburimin ne pjesen veriore dhe lindore.

Ne studimin e varianteve te hapjes se vendburimit jane mare ne konsiderate :

Kuota e rruges ekzistuese +1010m

Kuota e rruges ne teritorin e karieres se shfrytezimit +1050m

Kuota maksimale +1140 qe perkon me sheshin e shkalles se pare te shfrytezimit

Trasea ekzistuese qe do te rikonstrukrtohet per ru lidhur me rrugen rurale eshte 1340m

Gjatesia e rruges se re 1000m nga kuota = +1010 deri =1140m

Parametrat gjeometrike te zones se shfrytezimit

Shperndarjen e rezervave te nxjerreshme ne shkalle ne raport me sasine e pergjitheshme te rezervave

Pjeresia mesatare e siperfaqes se vendburimit

Mbas marjes ne konsiderate te faktoreve te mesiperm eshte bere studimi i varianteve te hapjes se vendburimit dhe eshte konkluduar se hapja do te behet nga rruga ekzistues në kuotën +1010m dhe të vazhdojë dëri në kuotën +1150m.

3.6. Sistemi i shhytezimit te treguesve tekniko-ekonomik te tyre.

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit

Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Ngarkimi i gurit gelqeror ne te gjitha sheshet e karierres parshikohet te kryhet me eskavator me kove 2 m^3

Bazuar sa me siper sistemi i shfrytezimit projektuar eshte i thjeshte me transport te prodhimit deri ne destinacion.

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane

Lartesia e shkalles se karrieres eshte	10m
Gjeresia e sheshit te punes nga	8-12 m ne 20-40-50m
Kendi i skarpates se shkalles	68°
Kendi i sharjes se skarpates se shkalles	51°
Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve	4m

Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar;

Rezimi i i gur gelqeror do te behet me lendes plasese te vendosur ne bira sonde

3.7. Radha dhe drejtimi i shfrytezimit

Shfrytezimi i vendburimit do te behet nga larte-poshte me shkalle te pare ne kuoten +1140 deri +1150 duke u ulur deri ne shkallen fundore me kuote =1010.

Drejtimi shfrytezimit do te jete nga lindja ne perendim

Orjentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terenit (shih planimetrine e karrieres ne gjendjen perfundimtare)

Per realizimine sasise se prodhimit te ne projektin e shfrytezimit te ketij objekti eshte parashikuar qe shfrytezimi te kryhet ne dy shkalle .

Per kushte pune normale krahas hapjes pergatitjes se karrieres te prodhohet gur gelqeror qe ne sasine 100 000 m^3 ne vitin e pare.

Elementet gjeometrike te karrieres ne gjendjen perfundimtare

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera do te kete formen e nje amfiteatri , me parametrat e me poshtem.

Tabela: Parmetrat e karrieres ne fund te shfrytezimit

Nr	Emertimi	Njesia	Vlera
1	Thellesia e vertikale e karrieres minimale dhe maksimale	m	50-110
2	Numuri i shkalleve minimale dhe maksimale	Nr	5-110
3	Gjatesia e karrieres ne plan ne pjese e siperme te saj do te jete,	m	127
4	Gjatesia ne sheshin e poshtem te karrieres,	m	772
5	Thellesia e karieres ne sheshin fundor te saj rreth	m	68
6	Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi te shtrirjes se karrieres eshte	Grade	51
7	Lartesia e shkalles	m	10
8	Orientimi i transheve te hyrjes eshte nga pjesa perendimore ne drejtim te lindjes		P-L
10	Siperfaqja e karrieres ne plan se bashku me transhete e hyrjeve	Km^2	**0.31**

3.8. Menyrat e rrezimit ne karriere e gurit gelgeror

Depozitimet e gurit gelqeror te projektuara per shfrytezim me karriere jane te forta, prandaj do te coptohen me lende plasese te vendosur ne bira sonde

Coptimi i shkembit ne karjere eshte projektuar te behet me keto metoda
1-Me matrapik te vendosur ne eskavator.

2-Me lende plasese te vendosur ne bira sonde

Coptimi me matrapik do te perdoret kryesisht per thyerjen e copave te medha te gurit gelqeror, hapjen e rrugeve te karieres, punimet pergatitore,shesheve te punes, etj.

3.9. Infrastruktura e nevojshme

Shfrytezimi i mineralit te gur gelqeror do te perdoret per ndertimin e infrastruktures rrugore lidhese me trasen e TAP-it dhe si lende e pare per industrine e ndertimit, prodhim inertesh per beton, asfaltobetoni etj.

Hapja e karrieres eshte realizuar me nje rruge te Re qe lidh objektin me rrugen rurale Potom-Corovode

Ne objekt do te instalohet nje impjante thyerje fraksionim te gurit gelqeror vetelevizes, kabina e furnizimit me energji elektrike dhe te sherbimit.

Subjekti ka instaluar objekte siperfaqsore tip kontoniere per zyra dhe te sherbimit te punonjesve.

Nuk do te kete investime te reja per ndertim kabine elektrike .
Lidhja telefonike e objektit me subjektin do te behet me telefona celular

3.10. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre

Lendet e para qe do te perdoren ne kete aktivitet eshte vete guri gelqeror i cili do sherbeje si material inert per ti ardhur ne ndihme projektit TAP per ndertimin e rrugeve dhe urave dhe ne nje faze te mevonshme per punimet civile te shtrimit te tubacionit te gazsjellesit.
Energjia elektrike dhe lendet djegese (karburat), uje etj.

3.11. Te dhena per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit.

Lendet e para te cilat do te perdoren jane: guri gelqerore, uji, energjia elektrike, lendet djegese te cilat do te perdoren si karburat per automjetet dhe makinerite te cilat do te vihen ne pune per shfrytezimin e gurit gelqeror. Sasite e ketyre lendeve do te percaktohem ne varesi te oreve te punes qe do te realizohen gjate dites.
Makinerite dhe automjetet i disponon shoqeria e cila do te zhvilloje kete aktivitet, uji dhe enrgjia elektrike do te sigurohet nga zona me e afert, lendet djegese do te blihen ne pikat e shitjes se karburanteve.

4. VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT

4.1 Të dhëna per zonen e zhvillimit te aktivitetit

Aktiviteti i "Shfrytezimit me Karriere i Gurit Gelqeror" (Shtesa), ndodhet ne zonen minerare me nr 56/6, objekti Gjergjove, Fshati Gjergjove, Njesia Administrative Potom, Bashkia Skrapar, Qarku Berat

4.2 Të dhëna per Bashkine Skrapar

Zona Gjeografike: Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

Harta territorial e Bashkise Skrapar

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 19,072 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km2. Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 15 banorë/km2 ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 22.93 banorë/km2.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM²
Berat	Qyteti Çorovodë	Çorovodë	Qyteti Çorovodë	12,403	19,072	831.44
		Qëndër Skrapar	Fshatrat; Zogas, Kalanjas, Dhores, Veseshtë, Polenë, Osojë, Grepckë, Liqeth, Rehovicë, Orizaj, Cerovë, Veleshnjë, Nishicë, Sharovë, Çerenisht, Buzuq, Munushtir, Radësh, Koritë, Mollas, Gradec, Vërzhezhë, Slatinjë, Strorë			
		Bogovë	Fshatrat; Bogovë, Kakrukë, Dobrushë, Përparim, Bargullas, Novaj, Nishovë, Jaupas, Selan			
		Vëndreshë	Fshatrat; Lavdar, Spatharë, Therepel, Valë, Vëndreshë e Madhe 1, Vëndreshë e Vogël 2, Vëndreshë e Malit 3, Ibro			
		Çepan	Fshatrat; Çepan, Muzhakë, Rog, Zabërzan i Ri, Zabërzan, Blezënckë, Malind, Muzhënckë, Sevran i madh, Sevran i Vogël, Qeshibes, Strënec, Kakos, Prishtë			
		Potom	Fshatrat; Potom, Gjergjovë, Koprënckë, Gërmenj, Visockë, Qafë, Helmës, Backë, Melskë, Nikollarë, Dyrmish, Staraveckë			
		Leshnje	Fshatrat; Turbohovë, Kapinovë, Krastë, Krushovë, Faqekuq, Gostënckë, Leshnje, Vlushë, Bërsakë			
		Gjerbës	Fshatrat; Mëlovë, Zaloshnjë, Gjerbës, Ujanik, Gradec, Strafickë, Vishanj, Barçi 1, Barçi 2, Kuç, Rehovë, Grëmsh, Gjogovicë, Floq			
		Zhepë	Fshatrat; Grevë, Posten, Kovaçanj, Gurazez, Çorrotat, Cericë, Zhepë, Leskovë, Trebël, Dunckë, Rromas, Tërrovë, Dobrenj, Buranj, Luadh, Shpatanj			

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Çorovodë, Qendër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, **Potom**, Leshnje, Gjerbës dhe Zhepë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Skrapar dhe pjesë e qarkut Berat. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 106 fshatra.

Bashkia e Skraparit ka një reliev të thyer malor, i cili ka një territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Popullsia e zonës është pakësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit nga largimet e banorëve drejt qyteteve të mëdha të Shqipërisë apo në emigrim. Vetë qyteti i Çorovodës humbi mbi 40 për qind të popullsisë mes viteve 2001 dhe 2011, ndërsa shumë nga komunat përbërëse kanë humbur mbi gjysmën e popullsisë.

Mungesa e perspektivës, kryesisht ajo e vendeve të punës, ka bërë që banorët e qytetit të vendosen për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre drejt qyteteve të mëdha, ndërsa banorët e zonave të thella janë larguar drejt qytetit të Çorovodës, si rezultat i mungesës së rrugëve dhe mjekëve në fshatrat e tyre. Problematika kryesore e banorëve të Çorovodës ka qenë gjendja e vështirë e rrugës kombëtare Skrapar-Berat.

Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoria dhe bujqësia, prodhime mjaft të vlerësuara këto në tregjet e vendit, ndër më të njohurat djathi dhe rakia e Skraparit. Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. Kanionet e Skraparit, po tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe vendas.

Mbi 20 mijë vizitorë mendohet se kanë prekur këtë bukuri të natyrës katër vitet e fundit. Turizmi fetar është një tjetër resurs i kësaj zone. Mijëra vizitorë shkelin në Skrapar çdo vit gjatë festës së Bektashinjve, gjatë ditëve të pelegrinazhit të muajit gusht. Por dhe këtë resurs të turizmit e pengon gjendja e vështirë e rrugës në fshatin Gjerbës, nga ku vizitorët duhet të udhëtojnë drejt malit të shenjtë Tomor.

Parku Kombëtar i Tomorit, është një tjetër resurs mjaft i rëndësishëm i kësaj zone, ende i pa vënë në shërbim të turizmit malor, si rezultat i mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve. Bashkimi i komunës Bogovë me Skraparin, i jep kësaj bashkie të re një tjetër mundësi për zhvillimin e turizmit. Uji që rrjedh nga zemra e malit, kodrat e hijshme, klima mjaft favorizuese dhe ushqimet e shijshme, i japin zonës elemente mjaft pozitive për zhvillimin e turizmit natyror. Ndryshe me pjesën tjetër të rrethit, nga Bogova nuk ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë. I gjithë fshati jeton me të ardhurat nga turizmi familjar. Pjesë e kësaj komune është fshati Novaj i njohur për gurin dekorativ.

4.3 Gjeologjia

Ndertimi gjeologjik i rrethit te Skraparit eshte i larmishem. Ne perberje te zonave tektonike "Kruja" dhe "Jonike" trualli i tij ndertohet kryesisht nga gelqerore te kretes dhe flish te paleogjenit, te cilet jane mbizoterues, por edhe magmatike, ne skajin verilindor te tij dhe molasa te kuaternarit ne pjesen e poshtme te lugines se Osumit. Stukturat gjeologjike me kryesore jane: antiklinalet e Tomor Kulmakut dhe te Corovodes, sinklinalet e Tomorices dhe te Policanit.

Relievi i Skraparit shtrihet nga lartesite rreth 170 m mbi nivelin e detit ne luginen e Osumit prane Policanit deri ne 2417 m, ne majen Cuka Partizane, ne malin e Tomorit. Lartesite deri 400 m mbi nivelin e detit zene 4.2 % te territorit te rrethit dhe shtrihen ne pjeset e poshteme te luginave te Osumit e te Tomorices. Gjithashtu, perfshin edhe kurrizet e ulta kodrinore ne veriperendim dhe ne veri te tij. Lartesite 400 - 1000 m perfshijne pjesen me te madhe te territorit (66,S % te tij). Ato shtrihen ne relievin kodrinor te rrethit, sidomos ne perendim, juglindje dhe ne te dy anet e lugines te Tomorices. Ky territor dallohet per shkallen me te larte te copetimit te relievit dhe shkallen me te larte te degradimit dhe shkretetirizimit te peizazhit.

Lartesite 1000 - 2000 m nga shtrirja zene vendin e dyte (27,S % te territorit). Ato perfshijne kurrizet malore ne lindje, jugperendim dhe pjesen e poshtme te vargut malor qendror. Dallohet per relievin me te ashper ne krahasim me dy katet e mesiperme. Lartesite mbi 2000 m kane shtrirje me te kufizuar, vetem 1,9 % te territorit te rrethit dhe zene kreshten dhe majat e Tomorit, Kulmakut dhe Ostrovices. Keto lartesi dallohen per relievin alpin me te thepisur.

Format kryesore te relievit jane luginat, kodrat dhe vargjet malore. Luginat jane formuar kryesisht ne terrigjene, qe mbushin strukturat sinklinale te permendura me lart. Keto lugina kane reliev me te bute, me kontraste me te vogla dhe teper te copetuar. Ato zgjerohen shkalle-shkalle drejt sektoreve te poshtem, ku shfaqen qarte disa nivele tarracore, ne te cilat jane vendosur tokat e punueshme dhe qendrat me te medha te banimit. Takohet edhe lugina e formuar ne strukturen antiklinale te Corovodes, qe ne berthame perbehet nga

gelqerore (sektori Corovode Hambull). Kjo dukuri interesante perben nje mosperputhje te morfologjise me strukturen gjeologjike. Pikerisht ne kete sektor te ndertuar nga gelqeroret eshte formuar kanioni madheshtor i Osumit, i shpallur monument natyre. Krahas luginave te zhvilluara pergjate strukturave gjeologjike, takohen edhe sektore te tyre te zhvilluar terthor ketyre strukturave, duke formuar keshtu gryka te ngushta dhe kanione: kanioni i Veseshtes nga lumi i Corovodes dhe i Micanit nga lumi i Osumit ne sektorin e siperme te tij per rrethin e Skraparit.

Pjesa me e madhe e kodrave eshte formuar mbi struktura antiklinale te ndertuara nga gelqerore dhe flishore. Kodrat me teper formojne grumbuj kodrinore, te perbera nga nje mori kurrizesh me drejtime te ndryshme dhe te ndara nga luginat e perrenjeve te shumte dhe teper gerryes. Ne shpatet, ne rreze, por edhe ne kreshte te tyre gjenden jo pak qendra te banuara, ne pergjithesi te vogla dhe tokat e tyre te punueshme, me teper ne formen e ngastrave teper te shperndara. Malet formojne vargje malore me drejtim te pergjithshem veriperendim juglindje. Ato jane formuar mbi struktura antiklinale te perbera nga gelqerore (vargu Tomor Kulmak dhe i Ostrovices) dhe terrigjene vargu perendimor.

Kreshtat gelqerore ne shumicen e rasteve jane te thepisura alpine dhe, ne sektore te vecante, te rrumbullakta apo te sheshta teper te karstezuara, ndersa kreshtat terrigjene kane morfologji te rrumbullaket Relievi i rrethit te Skraparit dallohet per shkallen e larte dhe shume te larte te copetimit horizontal. Shtrirjen me te madhe e kane territoret me shkalle copetimi 3 - 5 km/km2, pastaj ata me 5 - 7 km/km2, madje, ne disa sektore, edhe mbi kete vlere. Deri ne mesatare eshte shkalla e energjise se relievit: 300 m/km2, ku perfshihet mbi 52 % e territorit. Persa i perket kunderdrejtimit te shpateve, verehet se rrth 50 % e tyre i perket kunderdrejtimit perendimor dhe lindor. Te lidhura ngushte me faktoret strukturorolitologjike, te gerryerjes e te depozitimit, etj, jane edhe tipat e relievit. Shtrirjen me te gjere e ka relievi erozivo-denudues, kryesisht ne territoret e ndertuara nga shkembinjte flishore. Midis perberesve te ketij tipi relievi do te ve~ojme rreshqitjet dhe vat rat e erozionit (bokerimat). Pothuaj ne te gjitha shpatet e luginave ka rreshqitje te moshave dhe permasave te ndryshme. Midis me te medhave do te permendim rreshqitjet e Bogoves dhe ate afer fshatit Gradec, e cila ndodhi ne vitin 1963 dhe pati aktivitetit intensiv, gjate te cHit, ne me pak se ne nje jave, 5 shtepi u zhvendosen e u fundosen teresisht ne materialin e rreshqitur.

Rreshqitje te tjera te medha ka edhe ne Potom, ne Prishte, ne Therepel, etj. Vatrat e erozionit (bokerrimat) ose sektoret me shkalle te larte degradimi, madje shkretetirizimi me shtrirje me te madhe ne gjithe truallin shqiptar, takohen ne pjesen e siperme dhe te mesme te pellgut ujembledhes te Tomorices. Ketu edhe perrenjte baltore jane te shumte, ne shtreterit e te cileve ka sasi te madhe argjilash dhe rerash. Ne malet e ndertuara nga shkembinjte gelqerore eshte formuar tipi i relievit karstik, i cili perfaqesohet nga hinka e dolina karstike, nga shpella e sterra karstike etj. Perhapjen me te gjere keto forma e kane ne malin e Kulmakut, ku deri tani jane eksploruar disa sterra te shpallura monumente natyre 2 vjet me pare. Ka ende shume te tjera te paeksploruara. Relievi karstik ka shkembinj te

xhveshur ne siperfaqe, me lapieze ose shkrepa te formuara mbi shkembinj, qe e veshtiresojne shume kalimin e kembesoreve. Shenojme se ne malet e Tomorit dhe te Kulmakut shprehet edhe tipi i relievit akullnajor, i cili eshte me i dukshem ne shpatin verilindor te Tomorit. Cirqet akullnajore dhe morenat akullnajore ne afersi te fshatit Ujanik, tashme jane shpallur monument natyre. Aty, ku ndodhen cirqet, relievi eshte i tipit alpin, i veshtire per tu kaluar, ndersa kodrinat morenore jane perpunuar nga proceset e karstit dhe kane bimesi te pasur. Ne vazhdim do te flasim per njesite perberse me te medha te relievit te Skraparit. Vargu malor Tomor-Kulmak-Mican shtrihet ne veriperendim te Skraparit dhe ngrihet menjehere mbi territoret rrethuese.

4.4 Gjeografia e zones minerare

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti qe kerkohet per shfrytezim, eshte terren maloro-kodrinor. Zona e kerkuar per prodhimin e gurit gelqeror ndodhet ne anen veri-perendimore te fshatit Gjergjove.

4.5 Klima.

Objekti i kerkuar ben pjese ne Zonen qendrore te zones klimatike mesdhetare me elemente te zone prane bregdetare . Klima ne rajonin ku do te kryhen punimet e shfrytezimit dhe perpunimit te ranorit ka klime kontinetale me dimer relativisht te bute dhe vere te fresket dhe te ngrohte . Dimri qe pergjithesisht eshte i bute dhe me lageshti shoqerohet shpesh dhe me rreshje shiu. . Ne zone ka mbi 1650 ore ndriçim dielli, korriku 2855 ore dhe dhjetori 75 ore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 18.6 grade Celsius, ne Korrik dhe Gusht temperatura shkon 28-39 grade Celsius, ndersa ne janar zbret ne 6-10 grade Celsius, rralle here edhe me pak. Vlera mesatare e rreshjeve shkon ne 2215 mm/vit. Ne periudhen tetor-maj bien 75% e rreshjeve.

Sasia maksimale e rreshjeve eshte rregjistruar gati 168 mm shi ne 24 ore (2006). Lageshtia e ajrit rezulton sipas stineve nga 68% - 86%. Drejtimi i erërave eshte kryesisht Veri Perendim – Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla oblik me te Ushtrimi i aktiviteti te shfrytezimit dhe perpunimit te ranorit ,

4.6 Hidrologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Ne zone verehen trupa ujore te cilet krijohen gjate kohes me rreshje. Kur ka reshje, neper to rrjedhin me rrembim ujra siperfaqesore per shkak te pjerresise se madhe te terrenit. Keto ujra, derdhen ne luginen e Osumit, nuk pershkojne siperfaqen e karrieres pasi ndodhen ne nje dinivel te konsiderueshem.

4.7 Biodiversiteti

Flora

Zona në studim bën pjesë në listen e Habitateve Evropiane (6520). Shkurretat në këtë zonë kanë dëndësi të ulët dhë janë të fragmentuara si rezultat i ndërhyrjes së njeriut dhe erozonit. Në Shqipëri kjo lloj bimësie ka një përhapje të gjerë pothuajse në gjysmën e sipërfaqes së vendit. Për përgjithësisht kjo lloj bimësie është shumë e dëmtuar nga shfrytëzimi i prerjes .Vlera e bimësisë dhe habitateve të hasura brenda zonës së studimit është përgjithësisht e ulët. Zona ku do të zhvillohet projekti do të këtë ndikim të vogël në florë sepse pozicioni i saj përkon me një zonë ku niveli floristik nuk eshte i larte.

Fauna

Gjëndja e rënduar e habitatit zvogëlon mundësinë që lloje të ndryshme të faunës ta përdorin atë për ushqim dhe strehim. Karakteristikat fizike të terrenit kryesisht me pjesë të zhveshura, pjerrësi të lartë bëjnë të pamundur që ky mjedis të përdoret nga gjitarëtë lartë. Kjo zonë ka nivel të ulët faunistik .Zona ku do të zhvillohet projekti do të ketë ndikm të ulët në jetën e faunës sepse aktiviteti i saj shvillohet në një zonë me pjerrësi dhe pjeserisht të zhveshur nga bimësia.

Gjitarët –Popullata e gjitarëve vlerësohet shumë e ulët , kjo për shkak të nderhyrjeve dhe modifikimeve artificiale që kanë çuar në degradim të shkurretave, rritjes të erozionit. Ka mungesë të gjitareve të lartë, që përfaqësohen vetëm me dhelprën e cila e përdor këtë mjedis si rrugë kalimi.

Shpendët – Nga vrojtime të dokumentuara në terren, në zonën e projektit konfirmohet prania e 3 llojeve shpendësh, të cilët lidhen ngushtësisht me terrenet e hapura dhe shkurre të ulta.

Reptilët – Diversiteti i reptilëve në zonën e projektit vlerësohet shumë i ulët në lloje. Nga studimi në terren është vlerësuar prania vetëm e një lloji hardhuce.

Amfibët – Në zonën e projektit vlerësohet të mos këtë lloje të pranishme të amfibëve për shkak të pozicionit gjeografik të zonës.

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT

(ndikimet ne toke, uje, ajer, biodiversitet)

5.1 Ndikimi ne Toke

Nga zbatimi i ketij projekti ndikimet mbi toke do te jene te konsiderueshme, zhvillimi i ketij aktiviteti kerkon nje hapesire relativisht te madhe pasi kerkon nje shtrirje ne siperfaqe, ne total prej 0.129 km^2, por kuptohet qe nuk do te shfrytezohet e gjitha, sipas deklarimit te investitorit, do te shfrytezohet pjeserisht, sipas programit te punes, ku kjo jep edhe mundesine per rehabilitimin e pjesshem te siperfaqes se shfrytezuar. Kjo siperfaqe do te merret ne perdorim nga subjekti qe ka fituar Njoftim Fituesin per shfrytezimin e ketij objekti per siperfaqen shtese dhe duhet te rehabilitohet ne perfundim te shfrytezimit. Per te kryer nje rehabilitim te plote dhe afatgjate, duhet qe shfrytezimi te jete me shkalle te rregullta dhe te jete ruajtur shtresa e dheut ne siperfaqen e germuar. Perdorimi i tokes konsiston ne shfrytezimin afatgjate te saj si shesh i punimeve te karrieres, por edhe ne zenien e saj, ndonese ne siperfaqe te vogla, per depozitimin e perkohshem te sterileve, parkimi etj.

Ne lidhje me efektin e erozionit per skarpatat e trasese se rruges veme ne dukje se projekti do te ndikoje ndjeshem pasi eshte terren i pjerret.

Gjithashtu duhen kryer edhe punime mbrojtese per sheshet e depozitimit te inerteve, si dhe depozitimit e ruajtjes se gurit gelqeror.

Pritet nje ndryshim i struktures dhe perberjes se siperfaqes se tokes gjate shfrytezimit dhe pas punimeve te rehabilitimit te siperfaqeve te demtuara.

5.2 Ndikimi ne uje

Nga zbatimi i ketij projekti ndikimet ne ujera do te jene prezente. Ndikimi ne ujerat siperfaqesore e nentokesore do te vije si rrjedhoje e punimeve ne siperfaqe sipas skemes se shfrytezimit Hasja e burimeve ujore gjate germimeve do te shkaktonte daljen ne siperfaqe te ujerave nentokesore, fenomen i cili mund te shoqerohet edhe me erozion e shpelarje te tokes, varferim te ujerave nentokesore dhe ndotjen e ujerave siperfaqesore te burimeve te zones.

Gjithesesi ky fenomen, nuk pritet te ndodhe duke pasur parasysh perberjen gjeologjike te nentokes. Per ndikime te tilla, subjekti investitor duhet te marre masa per menaxhimin e ketyre burimeve ujore.

5.3 Ndikime ne ajer

Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin. Zhurmat jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonen e banuar, pasi ajo ndodhet ne nje distance prej 350 m nga vendit ku do shfrytezohet karriera. Kryesisht zhurmat shkaktohen, nga transporti, germimet e tokes shkembore, etj. Vibrimet nuk do te jene prezente gjate shfytezimit te karrieres. Fshati me i

afert i zones eshte fshati Gjergjove, i cili ndodhet ne anen perendimore te siperfaqes se karrieres ne nje distance prej 350 m ne vije ajrore.

Gjate punimeve do te kete demtim te rendesishem te peizazhit te zones, nga germimet dhe humbja e bimesise, ndryshimi i relievit, depozitimi i sterileve, hapja e rrugeve te reja brenda karrieres, ndertim i perkohshem i objekteve dhe magazinim te materialeve ndertimore. Sheshi i parkimit dhe makinerite gjithashtu do te kene efekt ne peizazhin e zones. Te gjitha keto punime dhe pakesimi i bimesise ndikojne ne uljen e cilesise se ajrit te zones, zone e cila vleresohet me cilesi te kenaqshme te parametrave mjedisore.

5.4 Ndikime ne Biodiversitet

Ndikimi kryesor dhe me i rendesishem ne mjedisin biologjik eshte gjate fazes se punimeve per hapjen dhe shfrytezimin e karrieres dhe restaurimin dhe mirembajtjen e aksesit rrugor. Nga zbatimi i ketij projekti qe ne total mund te demtohet nje siperfaqe prej 0.129 km2, por ne pergjithesi asnjehere nuk shfrytezohet e gjithe siperfaqja. Realisht pritet nje efekt domethenes ne demtimin e bimesise se zones. Demtimi i siperfaqes se tokes dhe i shtreses bimore sherbene si habitat per nje sere gjallesash, demtimi I saj do te ndikonte edhe ne largimin e faunes se zones. Kryesisht kafshet e egra, zogjte dhe insektet e zvarraniket.

Ndikimi i zhurmave do te ndikoje ne largimin e faunes ne nje rreze disa qindra metra ose edhe ne km, kjo kryesisht nga aktiviteti i germimit te shkembit qe sherbejne per shkeputjen e masivit shkembor.